



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.160

6 dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.858, datë 27.10.2010	Për miratimin, në parim, të marrëveshjeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje-daljeve, nëpërmjet pikave të kalimit kufitar Morinë (Kukës) – Vërmicë (Prizren), Qafë Morinë (Tropojë) – Qafë Morinë (Gjakovë) dhe Qafë Prush (Has)- Qafë Prush (Gjakovë), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, dhe protokolleve të kryerjes së veprimtarive të përbashkëta në këto pika të kalimit kufitar.....	8367
Vendim i GJK nr.36, datë 10.11.2010	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2008-149, datë 01.2.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë	8393
Vendim i ERE nr.81, datë 11.11.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	8396
Vendim i ERE nr.82, datë 11.11.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	8397
Vendim i ERE nr.83, datë 15.11.2010	Për miratimin e aplikimit të KESH sh.a., për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.....	8398

Vendim i ERE nr.84, datë 15.11.2010	Për miratimin e aplikimit të “CEZ shpërndarje” sh.a., për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.....	8398
Vendim i ERE nr.85, datë 15.11.2010	Për miratimin e shqyrtimit të aplikimit të OST sh.a., për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.....	8399
Vendim i ERE nr.86, datë 15.11.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energy Supply - AI” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	8400
Vendim i ERE nr.87, datë 15.11.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Energy Supply-AI” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	8401
Vendim i ERE nr.88, datë 15.11.2010	Për licencimin e shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	8402
Vendim i ERE nr.89, datë 15.11.2010	Për licencimin e shoqërisë “Ansara Koncesion” sh.p.k.....	8402
Vendim i ERE nr.90, datë 15.11.2010	Për dënimin me gjobë të “CEZ shpërndarje” sh.a., për shkeljet e konstatuara lidhur me moszbatimin nga ana e saj të vendimeve të ERE-s.....	8403

VENDIM
Nr.858, datë 27.10.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJEVE, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT TË
HYRJE-DALJEVE, NËPËRMJET PIKAVE TË KALIMIT KUFITAR MORINË (KUKËS) –
VËRMICË (PRIZREN), QAFË MORINË (TROPOJË) – QAFË MORINË (GJAKOVË) DHE
QAFË PRUSH (HAS)- QAFË PRUSH (GJAKOVË), NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS, DHE PROTOKOLLEVE TË KRYERJES SË
VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA NË KËTO PIKA TË KALIMIT KUFITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 6 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje-daljeve, nëpërmjet pikave të kalimit kufitar Morinë (Kukës) – Vërmicë (Prizren), Qafë Morinë (Tropojë) – Qafë Morinë (Gjakovë) dhe Qafë Prush (Has) - Qafë Prush (Gjakovë), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe protokolleve të kryerjes së veprimtarive të përbashkëta në këto pika të kalimit kufitar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PËRBASHKËTA TË
KONTROLLIT TË HYRJE-DALJEVE, NËPËRMJET PIKAVE TË KALIMIT KUFITAR MORINË
(KUKËS) - VËRMICË (PRIZREN), MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË
KOSOVËS**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim të referuara si “Palët” në këtë Marrëveshje):

duke marrë parasysh marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet dy vendeve;

nisur nga vullneti i mirë për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin;

me synimin arritjen e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit në mes dy vendeve dhe atij rajonal;

me qëllim thjeshtimin dhe lehtësimin e masave në lidhje me kontrollin kufitar në qarkullimin ndërkufitar ndërmjet dy vendeve;

në zbatim të nenit 14 të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim policor ndërkufitar”, nënshkruar në Prishtinë më 6 tetor 2009 dhe hyrë në fuqi më 20 mars 2010;

si konfirmim dhe i marrëveshjeve të tjera të arritura deri tani në nivelet e larta politike;

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit në pikat e kalimit kufitar, Morinë (Kukës)-Vërmicë (Prizren) në vijim referuar si PKK.

Kontrolli në hyrje për palën kosovare dhe ai në dalje për palën shqiptare do të kryhet në PKK-në Vërmicë.

Kontrolli në hyrje për palën shqiptare dhe ai në dalje për palën kosovare do të kryhet në PKK-në Morinë (Kukës).

PKK-të do të fillojnë të funksionojnë me procedura të përbashkëta kontrolli vetëm pas miratimit të protokolleve të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, në emër të palëve nënshkruese.

Neni 2

Palët do të krijojnë një Komitet të Përbashkët të Ekspertëve (në vijim KPE), i cili do të hartojë protokolle të posaçme mbi çështjet teknike dhe financiare që lidhen me funksionimin e PKK-ve, të protokolleve për përcaktimin e procedurave të përbashkëta të kontrollit, si dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes.

KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të përhershëm nga secila palë, që përfaqësojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje. Sipas kërkesës dhe çështjeve që trajtohen në KPE, marrin pjesë dhe agjenci të tjera të përfshira në menaxhimin e kufirit.

Palët janë të lira të shtojnë shtojca përkatëse në këtë Marrëveshje për të parashikuar çështjet që nuk rregullohen nga ajo.

Neni 3

Mosmarrëveshjet e mundshme rreth shpjegimit apo zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga KPE-ja.

Në rast se brenda afatit prej 3 muajsh, KPE-ja nuk do të mund të gjejë zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët në këtë Marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve të ndërsjella në rrugë diplomatike ndërmjet dy qeverive deri në fundin e muajit pasardhës.

Neni 4

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të dytë, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën se janë përmbytur të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacionet e vendeve të tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund ta denoncojë Marrëveshjen me anë të dorëzimit të një note verbale me shkrim në rrugë diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së vepruari gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit mbi denoncimin e saj nga pala tjetër.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në _____, më _____, në tri kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njëlloj të besueshme. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e Marrëveshjes, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT TË HYRJE-DALJEVE, NËPËRMJET PIKAVE TË KALIMIT KUFITAR QAFË MORINË (TROPOJË) – QAFË MORINË (GJAKOVË), MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim të referuara si “Palët” në këtë Marrëveshje):

duke marrë parasysh marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet dy vendeve;

nisur nga vullneti i mirë për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin;

me synimin arritjen e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit në mes dy vendeve dhe atij rajonal;

me qëllim thjeshtimin dhe lehtësimin e masave në lidhje me kontrollin kufitar në qarkullimin ndërkufitar ndërmjet dy vendeve;

në zbatim të nenit 14 të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim policor ndërkufitar”, nënshkruar në Prishtinë më 6 tetor 2009 dhe hyrë në fuqi më 20 mars 2010;

si konfirmim dhe i marrëveshjeve të tjera të arritura deri tani në nivelet e larta politike;

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit në pikat e kalimit kufitar, Qafë Morinë (Tropojë) – Qafë Morinë (Gjakovë) në vijim referuar si PKK.

Kontrolli në hyrje për palën kosovare dhe ai në dalje për palën shqiptare do të kryhet në PKK-në Qafë Morinë (Gjakovë).

Kontrolli në hyrje për palën shqiptare dhe ai në dalje për palën kosovare do të kryhet në PKK-në Qafë Morinë (Tropojë).

PKK-të do të fillojnë të funksionojnë me procedura të përbashkëta kontrolli vetëm pas miratimit të Protokolleve të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, në emër të palëve nënshkruese.

Neni 2

Palët do të krijojnë një Komitet të Përbashkët të Ekspertëve (në vijim KPE), i cili do të hartojë protokolle të posaçme mbi çështjet teknike dhe financiare që lidhen me funksionimin e PKK-ve, të protokolleve për përcaktimin e procedurave të përbashkëta të kontrollit, si dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes.

KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të përherëshëm nga secila Palë që përfaqësojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje. Sipas kërkesës dhe çështjeve që trajtohen, në KPE marrin pjesë dhe agjenci të tjera të përfshira në menaxhimin e kufirit.

Palët janë të lira të shtojnë shtojca përkatëse në këtë Marrëveshje për të parashikuar çështjet që nuk rregullohen nga ajo.

Neni 3

Mosmarrëveshjet e mundshme rreth shpjegimit apo zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga KPE-ja.

Në rast se brenda afatit prej 3 muajsh, KPE-ja nuk do të mund të gjejë zgjidhje të pranuar nga të dyja Palët në këtë Marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve të ndërsjella në rrugë diplomatike ndërmjet dy qeverive deri në fundin e muajit pasardhës.

Neni 4

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të dytë, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra –tjetrën se janë përmbushur të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacionet e vendeve të tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund ta denoncojë Marrëveshjen me anë të dorëzimit të një note verbale me shkrim në rrugë diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së vepruari gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit mbi denoncimin e saj nga pala tjetër.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në _____, më _____, në tri kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njëlloj të besueshme. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e Marrëveshjes, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT TË HYRJE/DALJEVE, NËPËRMJET PIKAVE TË KALIMIT KUFITAR QAFË PRUSH (HAS) – QAFË PRUSH (GJAKOVË) MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim të referuara si “Palët” në këtë Marrëveshje):

duke marrë parasysh marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet dy vendeve;

nisur nga vullneti i mirë për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin;

me synimin arritjen e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit në mes dy vendeve dhe atij rajonal;

me qëllim thjeshtimin dhe lehtësimin e masave në lidhje me kontrollin kufitar në qarkullimin ndërkufitar ndërmjet dy vendeve;

në zbatim të nenit 14 të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim policor ndërkufitar”, nënshkruar në Prishtinë më 6 tetor 2009 dhe hyrë në fuqi më 20 mars 2010;

si konfirmim dhe i marrëveshjeve të tjera të arritura deri tani në nivelet e larta politike;

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit në pikat e kalimit kufitar Qafë Prush (Has) – Qafë Prush (Gjakovë) në vijim referuar si PKK.

Kontrolli në hyrje për palën kosovare dhe ai në dalje për palën shqiptare do të kryhet në PKK-në Qafë Prush (Gjakovë).

Kontrolli në hyrje për palën shqiptare dhe ai në dalje për palën kosovare do të kryhet në PKK-në Qafë Prush (Has).

PKK-të do të fillojnë të funksionojnë me procedura të përbashkëta kontrolli vetëm pas miratimit të protokolleve të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, në emër të palëve nënshkruese.

Neni 2

Palët do të krijojnë një Komitet të Përbashkët të Ekspertëve (në vijim KPE), i cili do të hartojë protokolle të posaçme mbi çështjet teknike dhe financiare që lidhen me funksionimin e PKK-ve, të protokolleve për përcaktimin e procedurave të përbashkëta të kontrollit, si dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes.

KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të përhershëm nga secila palë që përfaqësojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje. Sipas kërkesës dhe çështjeve që trajtohen në KPE, marrin pjesë dhe agjenci të tjera të përfshira në menaxhimin e kufirit.

Palët janë të lira të shtojnë shtojca përkatëse në këtë Marrëveshje për të parashikuar çështjet që nuk rregullohen nga ajo.

Neni 3

Mosmarrëveshjet e mundshme rreth shpjegimit apo zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga KPE-ja.

Në rast se brenda afatit prej 3 muajsh, KPE-ja nuk do të mund të gjejë zgjidhje të pranuar nga të dyja palët në këtë Marrëveshje, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve të ndërsjella në rrugë diplomatike ndërmjet dy qeverive deri në fundin e muajit pasardhës.

Neni 4

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të dytë, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacionet e vendeve të tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund ta denoncojë Marrëveshjen me anë të dorëzimit të një note verbale me shkrim në rrugë diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së vepruari gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit mbi denoncimin e saj nga pala tjetër.


Kjo Marrëveshje nënshkruhet në _____, më _____, në tri kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njëlloj të besueshme. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e Marrëveshjes, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.



PLAN VENDOSJA E PKK




QAFE MORINE (TROPOJE-GJAKOVE)



PLAN VENDOSJA E PKK



QAFE MORINE (TROPOJE-GJAKOVE)






PLAN VENDOSJA E PKK



MORINE - VERMICE



KABINA E KONTROLLIT NE PKK



MORINE - VERMICE



Kabina ne territorin e Republikes se Kosoves



Kabina ne territorin e Republikes se Shqiperise



UDHEZIME PER KONTROLLIN NE PKK MORINE - VERMICE

Kritere te përgjithshme

<u>Zona e PPKK</u>	- Zona ku fillon PKK Morine (Shqipëri) dhe aty ku mbaron PKK Vermicë (Kosove) dhe anasjelltas quhet zone e Përbashkët e Pikave te Kontrollit Kufitar (ZPPKK) (Skema 2, shtojca 1) - Ne limitet e kësaj zone sipas drejtimit ne te dyja vendet vendosen table paralajmëruese ne gjuhet respektive dhe anglisht, qe tregon se po afrohesh ne PKK.								
<u>Zona e kontrollit te dokumentave</u>	- Zona e Kontrollit te Dokumentave (ZKD) është zona qe fillon nga kabinat e Kontrollit te palës shqiptare deri ne kabinat e kontrollit te palës kosovare. (Skema 2, shtojca 1). - ZKD është zone me qarkullim te limituar, lejohen vetëm për shtetasit dhe mjetet qe hyjnë/dalin nëpërmjet kufirit shtetëror. - Është e ndaluar qarkullimi i personave dhe parkimi i mjeteve qe nuk kane pune ne ZKD. - ZKD shënohet me vija kufizuese dhe tregohet me tabela. - Ambientet e punës se agjencive te te dy vendeve tregohen me tabela te shkruara ne gjuhet shqip, serbisht dhe anglisht (dhe anasjelltas). - Ne kabinat e punës se punonjësve te agjencive qe operojnë ne kufi te te dy vendeve vendosen mbishkrime dalluese, psh. kontrolli pasaportave, dogana, etj. - Ne hyrje te ZKD sipas korsive dhe drejtimit te lëvizjes vendosen tabela treguese për këmbësore, autovetura, autobusë dhe kamionë.								
<u>Punonjësi i PPKK</u>	Punonjësit e PKK mbajnë dokument identifikimi ne gjuhet respektive dhe me simbolet e agjencisë qe përfaqësojnë. Agjencitë qe operojnë ne PPKK janë:<table><tr><td>1. Policia Kufitare & Migracionit e Shqipërisë</td><td>1. Policia Kufitare e Kosovës</td></tr><tr><td>2. Shërbimi Doganor i Shqipërisë</td><td>2. Shërbimi Doganor i Kosovës</td></tr><tr><td>3. Shërbimi Veterinar i Shqipërisë</td><td>3. Shërbimi Veterinar i Kosovës</td></tr><tr><td>4. Shërbimi Fito-Sanitar i Shqipërisë</td><td>4. Shërbimi Fito-sanitar i Kosovës</td></tr></table>	1. Policia Kufitare & Migracionit e Shqipërisë	1. Policia Kufitare e Kosovës	2. Shërbimi Doganor i Shqipërisë	2. Shërbimi Doganor i Kosovës	3. Shërbimi Veterinar i Shqipërisë	3. Shërbimi Veterinar i Kosovës	4. Shërbimi Fito-Sanitar i Shqipërisë	4. Shërbimi Fito-sanitar i Kosovës
1. Policia Kufitare & Migracionit e Shqipërisë	1. Policia Kufitare e Kosovës								
2. Shërbimi Doganor i Shqipërisë	2. Shërbimi Doganor i Kosovës								
3. Shërbimi Veterinar i Shqipërisë	3. Shërbimi Veterinar i Kosovës								
4. Shërbimi Fito-Sanitar i Shqipërisë	4. Shërbimi Fito-sanitar i Kosovës								
<u>Kontrolli Kufitar</u>	- Kontrolli kufitar i dokumentacionit te udhëtareve dhe mjeteve behet ne zonën e kontrollit sipas parimit <i>te kontrollit me një ndalim</i>. - Autoritetet policore nuk evidentojnë daljet e shtetasve nga territoret respektive. - Kontrolli kufitar behet sipas drejtimit te lëvizjes, i përbashkët dhe i njëkohshëm nga te gjitha agjencitë qe operojnë ne kufi. Çdo pale kontrollon dhe evidenton hyrjen ne territorin e tij. Për problemet gjate dinamikes se punës konsultohet menjëherë me homologun e tij. - Veprimet bëhen sipas detyrave te përcaktuara ne aktet ligjore dhe n/ligjore te shërbimeve pjesëmarrëse. Çdo agjenci duhet te respektoje dhe te mos ndërhyje ne kompetencat e agjencisë përgjegjëse. - Për parregullsitë qe konstatohen, veprimet procedurale kryhen nga personeli i palës qe e konstaton parregullsinë sipas kriterave te përcaktuara ne protokollin e Zbatimit. - Orari punës ne Pikën e Përbashkët të Kalimit të Kufirit është 24 ore.								

		<u>Veprimet</u>
Dalja nga Republika e Shqipërisë	Udhëtare	▪ Kur shtetasi shqiptar/i huaj afrohet ZKD, duhet t'i deklarojë oficerit të doganës mallrat në përputhje me lejueshmërinë e legjislacioneve kombëtare përkatëse. Në varësi të llojit të mallrave duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi Fitosanitar, Shërbimi Veterinar ose Shërbime të tjera inspektimi. ▪ Në kabinën e përbashkët të kontrollit të dokumentave (ne territorin e Kosovës) paraqet dokumentin e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar. Kontrollori i Policisë Kufitare të Kosovës bën verifikimin e rregullsisë së pasaportës (së bashku me kolegun e Policisë Kufitare dhe Migracionit të Shqipërisë). ▪ Verifikimi konsiston ne : - Elementet mbrojtës të pasaportës - Rregullsinë e dokumentit - Krahason dokumentin me personin që e posedon - Afatet e dokumentit - Nëse ka ndërhyrje apo jo - Shtetasve të huaj i bëhet verifikim i shpejtë i ditëve të qëndrimit - Në hyrje, nëse shtetasi ka nevojë për vize ose jo - Nëse ka vize nëse është e vlefshme brenda afatit • Veprimet që kryhen nga kontrolloret : 1. Nëse dokumenti i kontrolluar rezulton i rregullt, punonjësi i PK të Kosovës bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative Kosovare. 2. Kur personi i paraqitur në kabine rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Shqipëria ose të hyrjes në Kosovë, pas konsultimit të përbashkët me kolegun shqiptar, kontrollori i PK të Kosovës, i dorëzon dokumentin homologut të tij shqiptar për të plotësuar aktin e refuzimit të daljes nga Republika e Shqipërisë (kur i refuzohet dalja), ose plotëson vetë ai aktin e refuzimit të hyrjes në Kosovë. Evidencat bëhen në sistem. 3. Kur kontrollori i PK të Kosovës dhe PKM të Shqipërisë kanë dyshime për ndërhyrje në dokumentin e paraqitur nga ana e udhëtarit, kontrollori, thërret përgjegjësin e turnit të palës kosovare dhe i jep pasaportën për ekzaminim të mëtejshëm në laborator. Pas verifikimit në laborator vazhdohet procedura në bazë të rezultatit të verifikimit.

Dalja nga Republika e Shqipërisë		<u>Veprimet</u>
	Autovetura	▪ Kur shtetasi shqiptar/i huaj udhëton me autoveturë, makina ndalohet ne ZKD ne vendin e shënuar STOP. Drejtuesi i mjetit duhet t'i deklarojë oficerit të doganës mallrat në përputhje me lejueshmërinë e legjislacioneve kombëtare përkatëse. Në varësi të llojit të mallrave duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi Fitosanitar, Shërbimi Veterinar ose Shërbime të tjera Inspektimi përkatëse. ▪ Pas kësaj i paraqet kontrollorit te PK te Kosovës dokumentat e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar (dokumentacionin e vet, te personave qe ka ne makine,nëse ka) dhe te mjetit me te cilin lëviz. ▪ Kontrollori i PK te Kosovës bën verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit te personave dhe mjetit. ▪ Kontrolli fizik: Oficeret e kontrollit janë gati për të bërë kontrollin në varësi të mjetit të transportit, ose të informacionit përkatës qe ka të bëjë me personat, mallrat sensitive, etj. Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fitosanitare(kur ka objekt te punës se tyre). Dokumentat gjate kontrollit fizik te automjetit i mban kontrollori i PK te Kosovës i cili me mbarimin e kontrollit fizik bën evidentimin ne sistem. ▪ Verifikimi konsiston ne : ○ Dokumentat e personave ○ Dokumentat e mjetit ○ Kontroll fizik te mjetit ▪ Veprimet qe kryhen nga kontrolloret : 1. Nëse dokumentat e personave dhe mjetit rezultojnë te rregullta, kontrollori i PK te Kosovës bën regjistrimin e te dhënave ne sistem sipas procedurave te parashikuara nga aktet administrative. 2. Kur personi/mjeti i paraqitur ne ZKK rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Shqipëria ose te hyrjes ne Kosove, pas konsultimit te përbashkët, kontrollori shqiptar refuzon daljen nga Republika e Shqipërisë, duke kryer evidentimin përkatës ne sistem si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar me këtë rast, dhe ne rastin e refuzimit te hyrjes ne Kosove, punonjësi i PK te Kosovës bën aktin e refuzimit te hyrjes ne territorin e tij. 3. Ne baze te vlerësimit te individual apo te përbashkët te te dy kontrolloreve bëhet verifikim ne rubrikën e INTERPOL-it për mjetet dhe personat. Rezultatet e verifikimit shkëmbehet ndërmjet dy policive.. 4. Kur gjate kontrollit gjykohet se makina duhet te kaloje ne kontroll te imët, i kërkohet drejtuesit te mjetit qe ta drejtoje makinën ne linjën e kontrollit te dyte. Kontrolli behet nga personeli i posaçëm, minimumi 2 persona, i palës qe ka kërkuar kontrollin me prezencën e palës tjetër. Grupi përbehet nga përfaqësues te Policisë Kufitare dhe doganave. Pala qe ka kërkuar kontrollin merr masa për mbikëqyrjen e personave qe janë ne mjet. 5. Kontrolli i bere evidentohet ne librin përkatës. 6. Ne përfundim te kontrollit sipas rezultatit te tij hartohen aktet procedurale, sipas modeleve qe ka pala qe kërkon kryerjen e kontrollit. 7. Nëse nga kontrolli nuk rezulton te ketë probleme, shtetasit dhe mjeti përpunohen jashtë radhe.

		<u>Veprimet</u>
Dalja nga Republika e Shqipërisë	Autobusë	▪ Kur ne ZKD vijnë autobusë për te kaluar nga Shqipëria për ne Kosove, punonjësi i palës Shqiptare merr listën e udhëtareve, dokumentat e tyre, te shoferit dhe stafit tjetër ne autobus, ▪ Vërtetimi i rregullsisë se dokumentave behet se bashku me punonjësin e palës se Kosovare. ▪ Nga grupi i kontrollit behet kontrolli i mjetit dhe bagazheve te pasagjereve ne praninë e drejtuesit te mjetit dhe poseduesit te bagazhit. ▪ Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fito-sanitare(kur ka objekt te punës se tyre). Dokumentat gjate kontrollit fizik i mban punonjësi i palës Kosovare, i cili bën evidentimin ne sistem. ▪ Verifikimi konsiston: si me sipër. ○ Dokumentat e personave ○ Dokumentat e mjetit ○ Kontroll fizik te mjetit ▪ Veprimet qe kryhen nga kontrolloret : 1. Nëse dokumentat e personave dhe mjetit rezultojnë te rregullta, kontrollori i palës kosovare bën regjistrimin e te dhënave ne sistem sipas procedurave te parashikuara nga aktet administrative te Kosovës. 2. Kur një ose me shume persona, ose mjeti rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Shqipëria ose te hyrjes ne Kosove, pas konsultimit te përbashkët, kontrollori shqiptar refuzon daljen nga Republika e Shqipërisë duke kryer evidentimin përkatës ne sistem si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar për këtë rast. Ne këtë rast personi/personat e parregullt nuk lejohen te dalin nga RSH, dhe autobusi me pasagjeret e tjerë vazhdon udhëtimin. Nëse automjeti nuk plotëson kushtet e daljes i refuzohet dalja nga Shqipëria dhe hyrja ne Kosove. Secili sipas rastit plotëson aktet procedurale. 3. Kontrolli fizik i autobusëve: Oficeret e kontrollit të doganës janë gati të bëjnë kontrollin në varësi të informacionit përkatës në lidhje me tipin e mallrave, me kriterin seleksionues, ose kërkesa të tjera bazuar në rregulloret e brendshme. Oficerët e policisë mund të ushtrojnë kontrole, objekt i përgjegjësisve të tyre, bazuar mbi analizën e riskut. 4. Kur gjate kontrollit gjykohet se mjeti duhet te kaloje ne kontroll me te imët, i kërkohet drejtuesit qe ta drejtoje mjetin ne linjën e dyte te kontrollit. Kontrolli behet nga personeli i palës qe e ka kërkuar, jo me pak se dy persona, me prezencën e palës tjetër. Grupi përbehet nga përfaqësues te Policisë Kufitare dhe doganave. Pasagjeret qëndrojnë ne terminal. 5. Kontrolli i bere evidentohet ne librin e hapur për këtë rast. 6. Ne përfundim te kontrollit sipas rezultatit te tij hartohen aktet sipas modeleve qe ka pala qe kërkon kryerjen e kontrollit. Kur nga kontrolli nuk rezulton te ketë probleme i jepet përparësi ne përpunim këtij mjeti
	Kamionë	1. Kontrolli fizik i kamionëve: Oficeret e kontrollit të doganës janë gati të bëjnë kontrollin në varësi të informacionit përkatës në lidhje me tipin e mallrave, me kriterin seleksionues, ose kërkesa të tjera bazuar në rregulloret e brendshme. Oficerët e policisë mund të ushtrojnë kontrole, objekt i përgjegjësisve të tyre, bazuar mbi analizën e riskut. 1. Kur gjate kontrollit gjykohet se mjeti duhet te kaloje ne kontroll me te imët, i kërkohet drejtuesit te mjetit qe ta drejtoje mjetin ne Linjën e dyte te kontrollit. Ne këtë godine kontrolli behet nga personel i posaçëm i palës qe ka kërkuar kontrollin, jo me pak se dy persona, me prezencën e palës tjetër. Grupi përbehet nga përfaqësues te Policisë Kufitare dhe doganave. 2. Kontrolli i bere evidentohet ne librin e hapur për këtë rast. 2. Ne përfundim te kontrollit sipas rezultatit te tij hartohen aktet sipas modeleve qe ka pala qe kërkon kryerjen e kontrollit. Kur nga kontrolli nuk rezulton te ketë probleme i jepet përparësi ne përpunim këtij mjeti 3.

		<u>Veprimet</u>
Dalja nga Republika e Kosovës	Udhëtare	▪ Kur shtetasi kosovar/i huaj afrohet ZKD, duhet t'i deklarojë oficerit të doganës mallrat në përputhje me lejueshmërinë e legjislacioneve kombëtare përkatëse. Në varësi të llojit të mallrave duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi Phyto-sanitar, Shërbimi Veterinar ose Shërbime të tjera inspektimi. ▪ Në kabinën e përbashkët të kontrollit të dokumentave (ne territorin e Shqipërisë) paraqet dokumentin e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar. Kontrollori i PKM se Shqipërisë, bën verifikimin e rregullsisë së pasaportës (së bashku me kolegun e Policisë Kufitare të Kosovës). ▪ Verifikimi konsiston ne : - Elementet mbrojtës të pasaportës - Rregullsinë e dokumentit - Krahason dokumentin me personin që e posedon - Afatet e dokumentit - Nëse ka ndërhyrje apo jo - Shtetasve të huaj i bëhet verifikim i shpejtë i ditëve të qëndrimit - Nëse hyrje, nëse shtetasi ka nevojë për vize ose jo - Nëse ka vize nëse është e vlefshme brenda afatit • Veprimet që kryhen nga kontrolloret : 1. Nëse dokumenti i kontrolluar rezulton i rregullt, punonjësi i PKM se Shqipërisë bën regjistrimin e të dhënave në sistem sipas procedurave të parashikuara nga aktet administrative shqiptare. 2. Kur personi i paraqitur në kabine rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Kosova ose të hyrjes në Shqipëri, pas konsultimit të përbashkët me kolegun kosovar, kontrollori i PKM se Shqipërisë, i dorëzon dokumentin homologut të tij kosovar për të plotësuar aktin e refuzimit të daljes nga Republika e Kosovës (kur i refuzohet dalja), ose plotëson vetë ai aktin e refuzimit të hyrjes në Shqipëri. Evidencat bëhen në sistem. 3. Kur kontrollori i PKM të Shqipërisë dhe PK të Kosovës kanë dyshime për ndërhyrje në dokumentin e paraqitur nga ana e udhëtarit, kontrollori, thërret përgjegjësin e turnit të palës shqiptare dhe i jep pasaportën për ekzaminim të mëtejshëm në laborator. Pas verifikimit në laborator vazhdohet procedura në bazë të rezultatit të verifikimit.

		<u>Veprimet</u>
Dalja nga Republika e Kosovës	Autovetura	▪ Kur shtetasi kosovar/i huaj udhëton me autoveturë, makina ndalohet ne ZKD ne vendin e shënuar STOP. Drejtuesi i mjetit duhet t'i deklarojë oficerit të doganës mallrat në përputhje me lejueshmërinë e legjislacioneve kombëtare përkatëse. Në varësi të llojit të mallrave duhet dhënë dokumentacioni i duhur nga Shërbimi Fitosanitar, Shërbimi Veterinar ose Shërbime të tjera Inspektimi përkatëse. ▪ Pas kësaj i paraqet kontrollorit te PKM te Shqipërisë dokumentat e udhëtimit të vlefshëm për të udhëtuar (dokumentacionin e vet, te personave qe ka ne makine,nëse ka) dhe te mjetit me te cilin lëviz. ▪ Kontrollori i PKM te Shqipërisë bën verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit te personave dhe mjetit. ▪ Kontrolli fizik: Oficeret e kontrollit janë gati për të bërë kontrollin në varësi të mjetit të transportit, ose të informacionit përkatës qe ka të bëjë me personat, mallrat sensitive, etj. Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fitosanitare(kur ka objekt te punës se tyre). Dokumentat gjate kontrollit fizik te automjetit i mban kontrollori i PKM te Shqipërisë i cili me mbarimin e kontrollit fizik bën evidentimin ne sistem. ▪ Verifikimi konsiston ne : ○ Dokumentat e personave ○ Dokumentat e mjetit ○ Kontroll fizik te mjetit ▪ Veprimet qe kryhen nga kontrolloret : 1. Nëse dokumentat e personave dhe mjetit rezultojnë te rregullta, kontrollori i PKM te Shqipërisë bën regjistrimin e te dhënave ne sistem sipas procedurave te parashikuara nga aktet administrative. 2. Kur personi/mjeti i paraqitur ne ZKK rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Kosova ose te hyrjes ne Shqipëri, pas konsultimit te përbashkët, kontrollori kosovar refuzon daljen nga Republika e Kosovës, duke kryer evidentimin përkatës ne sistem si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar me këtë rast, dhe ne rastin e refuzimit te hyrjes ne Shqipëri, punonjësi i PKM te Shqipërisë bën aktin e refuzimit te hyrjes ne territorin e tij. 3. Ne baze te vlerësimit te individual apo te përbashkët te te dy kontrolloreve bëhet verifikim ne rubrikën e INTERPOL-it për mjetet dhe personat. Rezultatet e verifikimit shkëmbehet ndërmjet dy policive.. 4. Kur gjate kontrollit gjykohet se makina duhet te kaloje ne kontroll te imët, i kërkohet drejtuesit te mjetit qe ta drejtoje makinën ne linjën e kontrollit te dyte. Kontrolli behet nga personeli i posaçëm, minimumi 2 persona, i palës qe ka kërkuar kontrollin me prezencën e palës tjetër. Grupi përbehet nga përfaqësues te Policisë Kufitare dhe doganave. Pala qe ka kërkuar kontrollin merr masa për mbikëqyrjen e personave qe janë ne mjet. 5. Kontrolli i bere evidentohet ne librin përkatës. 6. Ne përfundim te kontrollit sipas rezultatit te tij hartohen aktet procedurale, sipas modeleve qe ka pala qe kërkon kryerjen e kontrollit. 7. Nëse nga kontrolli nuk rezulton te ketë probleme, shtetasit dhe mjeti përpunohen jashtë radhe.

		<u>Veprimet</u>
Dalja nga Republika e Shqipërisë	Autobusë	▪ Kur ne ZKD vijnë autobusë për te kaluar nga Kosova për ne Shqipëri, punonjësi i palës Kosovare merr listën e udhëtareve, dokumentat e tyre, te shoferit dhe stafit tjetër ne autobus, ▪ Vërtetimi i rregullsisë se dokumentave behet se bashku me punonjësin e palës se Shqiptare. ▪ Nga grupi i kontrollit behet kontrolli i mjetit dhe bagazheve te pasagjereve ne praninë e drejtuesit te mjetit dhe poseduesit te bagazhit. ▪ Kontrolli fizik kryhet nga policia, dogana dhe shërbimet veterinarë e fito-sanitare(kur ka objekt te punës se tyre). Dokumentat gjate kontrollit fizik i mban punonjësi i palës shqiptare, i cili bën evidentimin ne sistem. ▪ Verifikimi konsiston: si me sipër. ○ Dokumentat e personave ○ Dokumentat e mjetit ○ Kontroll fizik te mjetit ▪ Veprimet qe kryhen nga kontrolloret : 1. Nëse dokumentat e personave dhe mjetit rezultojnë te rregullta, kontrollori i palës shqiptare bën regjistrimin e te dhënave ne sistem sipas procedurave te parashikuara nga aktet administrative te Shqipërisë. 2. Kur një ose me shume persona, ose mjeti rezulton se nuk përmbush kushtet e daljes nga Kosova ose te hyrjes ne Shqipëri, pas konsultimit te përbashkët, kontrollori kosovar refuzon daljen nga Republika e Kosovës duke kryer evidentimin përkatës ne sistem si dhe duke plotësuar formularin e parashikuar për këtë rast. Ne këtë rast personi/personat e parregullt nuk lejohen te dalin nga Republika e Kosovës, dhe autobusi me pasagjeret e tjerë vazhdon udhëtimin. Nëse automjeti nuk plotëson kushtet e daljes i refuzohet dalja nga Shqipëria dhe hyrja ne Kosove. Secili sipas rastit plotëson aktet procedurale. 3. Kontrolli fizik i autobusëve: Oficeret e kontrollit të doganës janë gati të bëjnë kontrollin në varësi të informacionit përkatës në lidhje me tipin e mallrave, me kriterin seleksionues, ose kërkesa të tjera bazuar në rregulloret e brendshme. Oficerët e policisë mund të ushtrojnë kontrolle, objekt i përgjegjësive të tyre, bazuar mbi analizën e riskut. 4. Kur gjate kontrollit gjykohet se mjeti duhet te kaloje ne kontroll me te imët, i kërkohet drejtuesit qe ta drejtoje mjetin ne linjën e dyte te kontrollit. Kontrolli behet nga personeli i palës qe e ka kërkuar, jo me pak se dy persona, me prezencën e palës tjetër. Grupi përbehet nga përfaqësues te Policisë Kufitare dhe doganave. Pasagjeret qëndrojnë ne terminal. 5. Kontrolli i bere evidentohet ne librin e hapur për këtë rast. 6. Ne përfundim te kontrollit sipas rezultatit te tij hartohen aktet sipas modeleve qe ka pala qe kërkon kryerjen e kontrollit. Kur nga kontrolli nuk rezulton te ketë probleme i jepet përparësi ne përpunim këtij mjeti
	Kamionë	1. Kontrolli fizik i kamionëve: Oficeret e kontrollit të doganës janë gati të bëjnë kontrollin në varësi të informacionit përkatës në lidhje me tipin e mallrave, me kriterin seleksionues, ose kërkesa të tjera bazuar në rregulloret e brendshme. Oficerët e policisë mund të ushtrojnë kontrolle, objekt i përgjegjësive të tyre, bazuar mbi analizën e riskut. 2. Kur gjate kontrollit gjykohet se mjeti duhet te kaloje ne kontroll me te imët, i kërkohet drejtuesit te mjetit qe ta drejtoje mjetin ne Linjën e dyte te kontrollit. Ne këtë godine kontrolli behet nga personel i posaçëm i palës qe ka kërkuar kontrollin, jo me pak se dy persona, me prezencën e palës tjetër. Grupi përbehet nga përfaqësues te Policisë Kufitare dhe doganave. 3. Kontrolli i bere evidentohet ne librin e hapur për këtë rast. 4. Ne përfundim te kontrollit sipas rezultatit te tij hartohen aktet sipas modeleve qe ka pala qe kërkon kryerjen e kontrollit. Kur nga kontrolli nuk rezulton te ketë probleme i jepet përparësi ne përpunim këtij mjeti

PROTOKOLL

NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT KUFITAR NË PIKAT E PËRBASHKËTA TË KALIMIT KUFITAR QAFË MORINË (TROPOJË) – QAFË MORINË (GJAKOVË)

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (këtej e tutje të quajtura “Palët kontraktuese”), në zbatim të Marrëveshjes “Për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në pikat e kalimit kufitar, Qafë Morinë (Tropojë) – Qafë Morinë (Gjakovë), në vijim referuar si PKK, midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, me qëllimin për të thjeshtëzuar dhe lehtësuar kryerjen e veprimtarive që kanë lidhje me kontrollin e kufirit në PKK, në interes të lehtësimit të kalimit kufitar në këto PKK, bien dakord:

Neni 1

Fusha e zbatimit

Protokolli gjen zbatim te të gjitha procedurat e përbashkëta të kontrollit policor në PKK, Qafë Morinë (Tropojë) – Qafë Morinë (Gjakovë), në vijim referuar si PKK, me qëllim thjeshtëzimin e procedurave të kontrollit kufitar në interes të lehtësimit në qarkullimin e njerëzve dhe mjeteve bazuar në parimin një ndalesë - një kontroll.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të këtij protokollit termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

1. “Administrator” – një prej palëve kontraktuese, e cila sipas marrëveshjes mes të dyja palëve është përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjediseve dhe pajisjeve të përbashkëta.

2. “Komiteti i përbashkët i ekspertëve” - Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve i krijuar (këtej e tutje KPE) sipas nenit 2 të marrëveshjes për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta në PKK-të e mësipërme.

3. “Kontrolli kufitar”- kontrolli i kryer në PKK nga autoritetet shtetërore përgjegjëse mbi personat, sendet e tyre personale, automjetet dhe mallrat, të cilat kalojnë kufirin shtetëror për hyrjen dhe daljen në territoret e palëve kontraktuese të këtij protokoll.

4. “Nëpunës” - çdo nëpunës i shërbimit të policisë kufitare, si dhe çdo nëpunës i autorizuar nga palët kontraktuese.

5. “Parimi me një ndalim” - kontrolli i kufirit i kryer nga nëpunës të të dyja palëve kontraktuese vetëm në një vendndodhje në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat duke përfshirë kontrollin e shtetasve, mjeteve dhe mallrave.

6. “Zona e përbashkët e pikave të kalimit kufitar” – këtej e tutje ZPPKK, sipërfaqja e përvijuar në shtojcën 1(1/a, 1/b dhe 1/c), e vendosur në territorin e dy palëve kontraktuese, ku nëpunësit respektivë kanë të drejtën të kryejnë kontrollin kufitar. ZPPKK-ja përfshin seksionin e rrugës në territorin e dy palëve kontraktuese, mjediset, mjediset ndihmëse, si dhe çdo mjedis tjetër të nevojshëm për kryerjen e kontrollit kufitar.

7. “Vendi i daljes” – pala kontraktuese, në të cilën nuk kryhet kontrolli kufitar në dalje.

8. “Vendi i hyrjes” – pala kontraktuese, në të cilën kryhet kontrolli kufitar në hyrje.

9. “Vendi pritës” - pala kontraktuese në territorin e së cilës agjencitë kompetente të vendit fqinj kryejnë kontroll kufitar.

10. “Vendi fqinj” - pala kontraktuese, në të cilën agjencitë kompetente kryejnë kontroll kufitar në territorin kombëtar të vendit pritës.

Neni 3

1. Për veprimtaritë e përbashkëta të përcaktuara sipas këtij protokolli, vendndodhja e mjediseve zyrtare do të jenë në territoret respektive, brenda ZPPKK-së ku kontrolli kufitar, sipas drejtimin të lëvizjes, kryhet nga nëpunësit shqiptarë dhe kosovarë. Nëpunësit shqiptarë dhe kosovarë kanë të drejtën të kryejnë kontrollin kufitar në ZPPKK, ku janë caktuar mjedise të veçanta zyrtare për ta.

2. Në përputhje me këtë protokoll, palët kontraktuese kanë përcaktuar:

a) Kufijtë e zonës së pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, siç tregohen në shtojcën 1 (1/a, 1/b dhe 1/c)).

b) Procedurat për të kthyer në vendin e origjinës ose në një vend tjetër sipas marrëveshjeve të ripranimit të një personi të ndaluar, të një personi nën arrest, të një personi, të cilit i është kufizuar liria ose që i është refuzuar hyrja, si dhe procedurat për transferimin e mallrave të sekuestruara apo provave që shoqërojnë ata në një vendndodhje tjetër zyrtare me qëllimin për të kryer kontrollin kufitar në vendin e tyre në përputhje me shtojcën 2.

c) Palët kontraktuese angazhohen për bashkëpunim në fushën e komunikimeve elektronike, teknologjisë së informacionit dhe shkëmbim të dhënash në formë elektronike. Detajet teknike do të përcaktohen nga Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve.

3. Mjediset zyrtare të përdorura për kontrollin kufitar nga të dyja palët kontraktuese do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore në përputhje me rregulloret kombëtare.

4. Tekstet e shënuara në mjediset e përbashkëta të përdorura nga nëpunësit e vendit fqinj do të jenë në shqip, serbisht dhe anglisht.

Neni 4

Nëpunësit e palëve kontraktuese kur marrin masa ose kryejnë kontrolle siç përcaktohen në këtë protokoll, do të shkëmbejnë informacion dhe të japin asistencë të përbashkët.

Neni 5

1. Të gjitha aktet ligjore të palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e kufirit do të zbatohen në ZPPKK. Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK-së do të ketë të njëjtat pasoja ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës Palë Kontraktuese.

2. Veprimtaritë ditore të kryera në ZPPKK-ja nga nëpunësit e palëve kontraktuese do të konsiderohen si të kryera në territorin e tyre.

Neni 6

1. Nëpunësit e secilës palë kontraktuese kanë të drejtën të ndalojnë, të arrestojnë ose të kufizojnë lirinë e një personi gjatë kontrollit kufitar, por vetëm në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv.

2. Kur merren masa sipas paragrafit 1 të këtij neni, nga nëpunësit e palëve kontraktuese, nëpunësi i vendit pritës do të informohet menjëherë.

3. Dispozitat e këtij neni nuk do të ndikojnë mbi vlefshmërinë e rregullave të vendit pritës që kanë të bëjnë me azilin dhe refugjatët.

Neni 7

1. Në ZPPKK kontrolli kufitar në hyrje është i detyrueshëm. Kontrolli kufitar në dalje është në diskrecionin e vendit të daljes. Nëse kryhen të dyja, kontrolli në dalje kryhet i pari.

2. Personat dhe mallrat u nënshtrohen kontrollit kufitar vetëm një herë. Nëse ka dyshime se një person i shpallur në kërkim është në ZPPKK, nëpunësit e vendit të daljes kanë të drejtën të përsërisin kontrollin e kufirit, pasi nëpunësit e vendit të hyrjes kanë dhënë pëlqimin e tyre.

3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, palët kontraktuese mund të bien dakord që të hiqet parimi me një ndalim dhe të rivendosen kontrollet e veçanta.

4. Të dyja palët kontraktuese mund të bien dakord për lehtësimin e kontrollit kufitar dhe të

vendosin për standardet minimale që duhet të respektohen, siç përcaktohen në shtojcën 2 të këtij protokolli.

Neni 8

1. Personat që nuk janë shtetas as të Republikës së Shqipërisë, dhe as të Republikës së Kosovës, të cilëve iu është refuzuar hyrja nga nëpunësit e vendit të hyrjes, nuk do t'u mohohet e drejta për t'u kthyer në vendin e daljes. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e vendit të hyrjes do të lejohen të kthehen në vendin e daljes.

Neni 9

1. Në rastet e parimit me një ndalim, mallrat mund të sekuestrohen nga nëpunësit e vendit të hyrjes.

2. Në rastet kur kontrollet kryhen në mënyrë të veçantë, nëpunësit e vendit të hyrjes mund të ndalojnë, arrestojnë ose të kufizojnë lirinë e personave ose të sekuestrojnë mallrat vetëm pasi kontrolli i kufirit të ketë përfunduar nga vendi i daljes dhe vetëm në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare.

3. Të hollat dhe letrat me vlerë të sekuestruara nga nëpunësit e vendit fqinj gjatë kryerjes së kontrollit të kufirit, si dhe mallrat e sekuestruara duhet të kthehen në vendin fqinj dhe nuk do t'u nënshtrohen rregullave të eksportit.

Neni 10

1. Nëpunësit e të dyja palëve kontraktuese do të kenë një kartë identiteti zyrtare dhe autorizim zyrtar, që i jep nëpunësit të drejtën të hyjë në ZPPKK, të punojë në të dhe të kthehet në vendin fqinj.

2. Karta e identitetit do të ketë një numër të veçantë dhe do të përmbajë titullin e PPKK-së, emrin dhe mbiemrin e personit, së bashku me një fotografi, funksionin dhe numrin zyrtar. Teksti i autorizimit zyrtar dhe karta e identitetit do të shkruhen në të dyja gjuhët. Autorizimi zyrtar dhe karta e identitetit lëshohen nga autoritetet policore të të dyja vendeve, secili për punonjësit e palës së tij. Palët kontraktuese duhet të informojnë sa më shpejt që të jetë e mundur njëra-tjetrën, për çdo ndryshim në personelin e agjencive të kufirit në PPKK.

3. Dispozitat në paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni nuk ndalojnë autoritetet policore të Republikës së Shqipërisë që të refuzojnë hyrjen në ZPPKK për nëpunës të caktuar të Republikës së Kosovës. Nëse një nëpunësi të Kosovës/Shqipërisë i është refuzuar hyrja në Shqipëri/Kosovë, autoritetet përkatëse të Shqipërisë/Kosovës do të informojnë pa vonesë autoritetet përkatëse rreth refuzimit.

4. Nëpunësit e të dyja palëve do të mbajnë uniforma gjatë kohës që ata janë të pranishëm në ZPPKK. Në rastet përjashtimore dhe kur bien dakord nga autoritetet kompetente, nëpunësit mund të mbajnë veshje civile, me shenjën "Policia", të dukshme në anën e parme, ose duke mbajtur dallueshëm kartat e identitetit. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet zyrtarëve, për ndryshimet që mund të ndodhin sipas këtij paragrafi.

Neni 11

1. Nëpunësit e palëve kontraktuese do të mbajnë vetëm një armë të shkurtër shërbimi, kalibri 9 mm (këtëj e tutje armë brezi) nëse ata janë të autorizuar në këtë mënyrë nga legjislacioni kombëtar. Përveç kësaj, nëpunësit e policisë mund të mbajnë pranga, shkopinj gome dhe gazlotsjellës kur janë në detyrë në ZPPKK.

2. Forca, duke përfshirë forcën vdekjeprurëse, mund të përdoret vetëm në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme në bazë të legjislacionit kombëtar. Përdorimi i forcës duhet të jetë në përputhje me rrezikun dhe nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nevojës për situatën konkrete. Nëpunësit e palëve kontraktuese kanë të drejtën të përdorin forcën fizike për të izoluar personat që prishin rendin në ZPPKK. Autoritetet respektive do të njoftohen për këto masa pa vonesë.

Neni 12

1. Pajisjet zyrtare të palëve kontraktuese, të nevojshme për të kryer detyra në lidhje me kontrollin e kufirit në ZPPKK, mund të instalohen dhe të përdoren nga nëpunësit e tyre respektivë në kuadër të realizimit të detyrës.

2. Qentë e shërbimit të të dyja Palëve do të konsiderohen si pajisje zyrtare dhe do të përdoren në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Qentë e shërbimit do të përdoren vetëm për marrjen e masave detyruese ndaj individëve në përputhje me paragrafin 2, neni 11.

3. Për çdo lloj ndryshimi që mund të ndodhë në lidhje me paragrafin 1 dhe 2, palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë nëpërmjet nëpunësve të tyre në ZPPKK.

Neni 13

Nëpunësit e të dy palëve kontraktuese gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje kur kryejnë detyrat e tyre në ZPPKK.

Neni 14

Orari i funksionimit të kësaj ZPPKK-je është 24/7. Mënyra se si do të kryhet kontrolli kufitar në vendndodhjet zyrtare të caktuara për kontroll nga palët kontraktuese do të caktohen në shtojcën përkatëse të këtij protokollit siç është rënë dakord nga KPE-ja.

Neni 15

Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve të përbashkëta të ZPPKK do të miratohen nga KPE-ja dhe do të ndahen në mënyrë të barabartë mes palëve.

Neni 16

1. Objektet që janë për përdorim zyrtar në ZPPKK do të përdoren dhe transportohen pa detyrime doganore ose kufizime ose taksa të tjera. E njëjta gjë do të zbatohet për automjetet zyrtare dhe private të përdorura nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

2. Letrat, dokumentet dhe mjetet e tjera që përmbajnë të dhëna të përdorura nga nëpunësit e secilës palë kontraktuese kur kryejnë detyrat në ZPPKK, si dhe posta zyrtare dhe pajisjet zyrtare nuk do të kontrollohen apo sekuestrohen nga nëpunësit e palës tjetër kontraktuese.

Neni 17

1. Palët kontraktuese do të lejojnë instalimin, zhvendosjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit, të përdorura ekskluzivisht në veprimet e vendndodhjeve zyrtare të përcaktuara për kontrollin e kufirit nga palët kontraktuese dhe do të lejojnë edhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet përkatëse të secilës palë.

2. Përdorimi i pajisjeve të tilla do të konsiderohet si trafik i brendshëm në territoret respektive të palëve kontraktuese.

Neni 18

Shtesat dhe ndryshimet e këtij protokollit siç është rënë dakord mes palëve do të hartohen me shkrim dhe do të jenë pjesë përbërëse e këtij protokollit.

Neni 19

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij protokollit do të zgjidhet nga Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve.

2. Nëse KPE-ja nuk do të jetë në gjendje të gjejë një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët brenda tre muajve, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me bisedime dypalëshe nëpërmjet kanaleve diplomatike të të dyja qeverive deri në fund të muajit pasardhës.

Neni 20

1. Ky protokoll hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të dytë, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën se janë përbushur të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacionet e vendeve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij protokollit.

2. Ky protokoll përfundohet për një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund të denoncojë Protokollin duke paraqitur notë verbale me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Protokollit do të pushojë së ekzistuari 6 muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit nga pala tjetër.

3. Secila prej palëve kontraktuese mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e këtij protokollit për shkak të rendit publik apo shëndetit publik. Fillimi apo anulimi do t'i komunikohet me shkrim pa vonesë palës tjetër kontraktuese. Pezullimi do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së një njoftimi të tillë.

4. Ky protokoll nënshkruhet më _____, në _____, në dy kopje origjinale secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjes në interpretimin e protokollit, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

PROTOKOLL

NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT KUFITAR NË PIKAT E KALIMIT KUFITAR MORINË (KUKËS) - VËRMICË (PRIZREN)

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (këtej e tutje të quajtura "Palët kontraktuese"), në zbatim të Marrëveshjes "Për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në pikat e kalimit kufitar, Morinë (Kukës) - Vërmicë (Prizren), midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, me qëllimin për të thjeshtëzuar dhe lehtësuar kryerjen e veprimtarive që kanë lidhje me kontrollin e kufirit në PKK, në interes të lehtësimit të kalimit kufitar në këto PKK, bien dakord:

Neni 1

Fusha e zbatimit

Protokollit gjen zbatim të të gjitha procedurat e përbashkëta të kontrollit policor në PKK Morinë (Kukës) - Vërmicë (Prizren). Me qëllim thjeshtëzimin e procedurave të kontrollit kufitar në interes të lehtësimit në qarkullimin e njerëzve dhe mjeteve bazuar në parimin një ndalesë-një kontroll.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të këtij protokollit termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

1. "Administrator" – një prej palëve kontraktuese, e cila sipas marrëveshjes mes të dyja palëve është përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjediseve dhe pajisjeve të përbashkëta.

2. “Komiteti i përbashkët i ekspertëve” - Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve i krijuar (këtej e tutje KPE) sipas nenit 2 të marrëveshjes për hapjen e PKK-ve të përbashkëta.

3. “Kontrolli kufitar”- kontrolli i kryer në të dy PKK-të nga autoritetet shtetërore përgjegjëse mbi personat, sendet e tyre personale, automjetet dhe mallrat, të cilat kalojnë kufirin shtetëror për hyrjen dhe daljen në territoret e palëve kontraktuese të këtij protokollit.

4. “Nëpunës” - çdo nëpunës i shërbimit të policisë kufitare, si dhe çdo nëpunës i autorizuar nga palët kontraktuese.

5. “Parimi me një ndalim” - kontrolli i kufirit i kryer nga nëpunës të të dyja palëve kontraktuese vetëm në një vendndodhje në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat duke përfshirë kontrollin e shtetasve, mjeteve dhe mallrave.

6. “Zona e përbashkët e pikave të kalimit kufitar” – këtej e tutje ZPPKK, sipërfaqja e përvijuar në shtojcën 1(1/a, 1/b dhe 1/c), e vendosur në territorin e dyja palëve kontraktuese, ku nëpunësit respektivë kanë të drejtën të kryejnë kontrollin kufitar. ZPPKK-ja përfshin seksionin e rrugës në territorin e të dyja palëve kontraktuese, mjediset, mjediset ndihmëse, si dhe çdo mjedis tjetër të nevojshëm për kryerjen e kontrollit kufitar.

7. “Vendi i daljes” – pala kontraktuese, në të cilën nuk kryhet kontrolli kufitar në dalje.

8. “Vendi i hyrjes” – pala kontraktuese, në të cilën kryhet kontrolli kufitar në hyrje.

9. “Vendi pritës” - pala kontraktuese, në territorin e së cilës agjencitë kompetente të vendit fqinj kryejnë kontroll kufitar.

10. “Vendi fqinj” - pala kontraktuese, në të cilën agjencitë kompetente kryejnë kontroll kufitar në territorin kombëtar të vendit pritës.

Neni 3

1. Për veprimtaritë e përbashkëta të përcaktuara sipas këtij protokollit, vendndodhja e mjedisve zyrtare do të jetë në territoret respektive, brenda ZPPKK-së ku kontrolli kufitar, sipas drejtimit të lëvizjes, kryhet nga nëpunësit shqiptarë dhe kosovarë. Nëpunësit shqiptarë dhe kosovarë kanë të drejtën të kryejnë kontrollin kufitar në ZPPKK, ku janë caktuar mjedise të veçanta zyrtare për ta.

2. Në përputhje me këtë protokoll palët kontraktuese kanë përcaktuar:

a) Kufijtë e zonës së përbashkët të pikave të kalimit kufitar siç tregohen në shtojcën 1 (1/a, 1/b dhe 1/c).

b) Procedurat për të kthyer në vendin e origjinës ose në një vend tjetër sipas marrëveshjeve të ripranimit të një personi të ndaluar, të një personi nën arrest, të një personi, të cilit i është kufizuar liria ose që i është refuzuar hyrja, si dhe procedurat për transferimin e mallrave të sekuestruara apo provave që shoqërojnë ata në një vendndodhje tjetër zyrtare me qëllimin për të kryer kontrollin kufitar në vendin e tyre në përputhje me shtojcën 2.

c) Palët kontraktuese angazhohen për bashkëpunim në fushën e komunikimeve elektronike, teknologjisë së informacionit dhe shkëmbim të dhënash në formë elektronike. Detajet teknike do të përcaktohen nga Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve.

3. Mjediset zyrtare të përdorura për kontrollin kufitar nga të dyja palët kontraktuese do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore në përputhje me rregulloret kombëtare.

4. Tekstet e shënuara në mjediset e përbashkëta të përdorura nga nëpunësit e vendit fqinj do të jenë në shqip, serbisht dhe anglisht.

Neni 4

Nëpunësit e palëve kontraktuese kur marrin masa ose kryejnë kontrolle, siç përcaktohen në këtë protokoll, do të shkëmbejnë informacion dhe të japin asistencë të përbashkët.

Neni 5

1. Të gjitha aktet ligjore të palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e kufirit do të zbatohen në ZPPKK. Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK-në do të ketë të njëjtat pasoja ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës Palë Kontraktuese.

2. Veprimtaritë ditore të kryera në ZPPKK nga nëpunësit e palëve kontraktuese do të konsiderohen si të kryera në territorin e tyre.

Neni 6

1. Nëpunësit e secilës palë kontraktuese kanë të drejtën të ndalojnë, të arrestojnë ose të kufizojnë lirinë e një personi gjatë kontrollit kufitar, por vetëm në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv.

2. Kur merren masa sipas paragrafit 1 të këtij neni, nga nëpunësit e palëve kontraktuese, nëpunësi i vendit pritës do të informohet menjëherë.

3. Dispozitat e këtij neni nuk do të ndikojnë mbi vlefshmërinë e rregullave të vendit pritës që kanë të bëjnë me azilin dhe refugjatët.

Neni 7

1. Në ZPPKK kontrolli kufitar në hyrje është i detyrueshëm. Kontrolli kufitar në dalje është në diskrecionin e vendit të daljes. Nëse kryhen të dyja, kontrolli në dalje kryhet i pari.

2. Personat dhe mallrat u nënshtrohen kontrollit kufitar vetëm një herë. Nëse ka dyshime se një person i shpallur në kërkim është në ZPPKK, nëpunësit e vendit të daljes kanë të drejtën të përsëritin kontrollin e kufirit, pasi nëpunësit e vendit të hyrjes kanë dhënë pëlqimin e tyre.

3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, palët kontraktuese mund të bien dakord që të hiqet parimi me një ndalim dhe të rivendosen kontrollet e veçanta.

4. Të dyja palët kontraktuese mund të bien dakord për lehtësimin e kontrollit kufitar dhe të vendosin për standardet minimale që duhet të respektohen, siç përcaktohen në shtojcën 2 të këtij protokollit.

Neni 8

1. Personat që nuk janë shtetas as të Republikës së Shqipërisë, dhe as të Republikës së Kosovës, të cilëve iu është refuzuar hyrja nga nëpunësit e vendit të hyrjes, nuk do t'u mohohet e drejta për t'u kthyer në vendin e daljes. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e vendit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në vendin e daljes.

Neni 9

1. Në rastet e parimit me një ndalim mallrat mund të sekuestrohen nga nëpunësit e vendit të hyrjes.

2. Në rastet kur kontrollet kryhen në mënyrë të veçantë, nëpunësit e vendit të hyrjes mund të ndalojnë, arrestojnë ose të kufizojnë lirinë e personave, ose të sekuestrojnë mallrat vetëm pasi kontrolli i kufirit të ketë përfunduar nga vendi i daljes dhe vetëm në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare.

3. Të hollat dhe letrat me vlerë të sekuestruara nga nëpunësit e vendit fqinj gjatë kryerjes së kontrollit të kufirit, si dhe mallrat e sekuestruara duhet të kthehen në vendin fqinj dhe nuk do t'u nënshtrohen rregullave të eksportit.

Neni 10

1. Nëpunësit e të dyja palëve kontraktuese do të kenë një kartë identiteti zyrtare dhe autorizim zyrtar, që i jep nëpunësit të drejtën të hyjë në ZPPKK, të punojë në të dhe të kthehet në vendin fqinj.

2. Karta e identitetit do të ketë një numër të veçantë dhe do të përmbajë titullin e PPKK-së,

emrin dhe mbiemrin e personit, së bashku me një fotografi, funksionin dhe numrin zyrtar. Teksti i autorizimit zyrtar dhe karta e identitetit do të shkruhen në të dyja gjuhët. Autorizimi zyrtar dhe karta e identitetit lëshohen nga autoritetet policore të të dyja vendeve, secili për punonjësit e palës së tij. Palët kontraktuese duhet të informojnë sa më shpejt që të jetë e mundur njëra-tjetrën, për çdo ndryshim në personelin e agjencive të kufirit në PKK.

3. Dispozitat në paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni nuk ndalojnë autoritetet policore të Republikës së Shqipërisë, që të refuzojnë hyrjen në ZPPKK për nëpunës të caktuar të Republikës së Kosovës. Nëse një nëpunësi të Kosovës/Shqipërisë i është refuzuar hyrja në Shqipëri/Kosovë, autoritetet përkatëse të Shqipërisë/Kosovës do të informojnë pa vonesë autoritetet përkatëse rreth refuzimit.

4. Nëpunësit e të dyja palëve do të mbajnë uniforma gjatë kohës që ata janë të pranishëm në ZPPKK. Në rastet përjashtimore dhe kur bihet dakord nga autoritetet kompetente, nëpunësit mund të mbajnë veshje civile, me shenjën "Policia", të dukshme në anën e parme, ose duke mbajtur dallueshëm kartat e identitetit. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet zyrtarëve për ndryshimet që mund të ndodhin sipas këtij paragrafi.

Neni 11

1. Nëpunësit e palëve kontraktuese do të mbajnë vetëm një armë të shkurtër shërbimi, kalibri 9 mm (këtëj e tutje armë brezi) nëse ata janë të autorizuar në këtë mënyrë nga legjislacioni kombëtar. Përveç kësaj, nëpunësit e policisë mund të mbajnë pranga, shkopinj gome dhe gaz lotsjellës kur janë në detyrë në ZPPKK.

2. Forca, duke përfshirë forcën vdekjeprurëse, mund të përdoret vetëm në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe të nevojës ekstreme në bazë të legjislacionit kombëtar. Përdorimi i forcës duhet të jetë në përputhje me rrezikun dhe nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nevojës për situatën konkrete. Nëpunësit e palëve kontraktuese kanë të drejtën të përdorin forcën fizike për të izoluar personat që prishin rendin në ZPPKK. Autoritetet respektive do të njoftohen për këto masa pa vonesë.

Neni 12

1. Pajisjet zyrtare të palëve kontraktuese, të nevojshme për të kryer detyra në lidhje me kontrollin e kufirit në ZPPKK mund të instalohen dhe të përdoren nga nëpunësit e tyre respektivë në kuadër të realizimit të detyrës.

2. Qentë e shërbimit të të dyja palëve do të konsiderohen si pajisje zyrtare dhe do të përdoren në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Qentë e shërbimit do të përdoren vetëm për marrjen e masave detyruese ndaj individëve në përputhje me paragrafin 2, neni 11.

3. Për çdo lloj ndryshimi që mund të ndodhë në lidhje me paragrafët 1 dhe 2 palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë nëpërmjet nëpunësve të tyre në ZPPKK.

Neni 13

Nëpunësit e të dyja palëve kontraktuese gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje kur kryejnë detyrat e tyre në ZPPKK.

Neni 14

Orari i funksionimit të kësaj PPKK-je është 24/7. Mënyra sesi do të kryhet kontrolli kufitar në vendndodhjet zyrtare të caktuara për kontroll nga palët kontraktuese do të caktohet në shtojcën përkatëse të këtij protokolli, siç është rënë dakord nga KPE-ja.

Neni 15

Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve të përbashkëta të PPK-së do të miratohen nga KPE-ja dhe do të ndahen në mënyrë të barabartë mes palëve.

Neni 16

1. Objektet që janë për përdorim zyrtar në ZPPKK do të përdoren dhe transportohen pa detyrime doganore ose kufizime ose taksa të tjera. E njëjta gjë do të zbatohet për automjetet zyrtare dhe private të përdorura nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

2. Letrat, dokumentet dhe mjetet e tjera që përmbajnë të dhëna të përdorura nga nëpunësit e secilës palë kontraktuese kur kryejnë detyrat në ZPPKK, si dhe posta zyrtare dhe pajisjet zyrtare nuk do të kontrollohen apo sekuestrohen nga nëpunësit e palës tjetër kontraktuese.

Neni 17

1. Palët kontraktuese do të lejojnë instalimin, zhvendosjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit, të përdorura ekskluzivisht në veprimet e vendndodhjeve zyrtare, të përcaktuara për kontrollin e kufirit nga palët kontraktuese dhe do të lejojnë edhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet përkatëse të secilës palë.

2. Përdorimi i pajisjeve të tilla do të konsiderohet si trafik i brendshëm në territoret respektive të palëve kontraktuese.

Neni 18

Shtesat dhe ndryshimet e këtij protokollit, siç është rënë dakord mes palëve, do të hartohen me shkrim dhe do të jenë pjesë përbërëse e këtij Protokollit.

Neni 19

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij protokollit do të zgjidhet nga Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve.

2. Nëse KPE-ja nuk do të jetë në gjendje të gjejë një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët brenda tre muajve, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me bisedime dypalëshe nëpërmjet kanaleve diplomatike të të dyja qeverive deri në fund të muajit pasardhës.

Neni 20

1. Ky protokoll hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të dytë, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën se janë përbushur të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacionet e vendeve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij protokollit.

2. Ky protokoll përfundohet për një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund të denoncojë Protokollin duke paraqitur notë verbale me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Protokollit do të pushojë së ekzistuari 6 muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit nga pala tjetër.

3. Secila prej palëve kontraktuese mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e këtij protokollit për shkak të rendit publik apo shëndetit publik. Fillimi apo anulimi do t'i komunikohet me shkrim pa vonesë palës tjetër kontraktuese. Pezullimi do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së një njoftimi të tillë.

Ky protokoll nënshkruhet më _____, në _____, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjes në interpretimin e protokollit, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

VENDIM
Nr.36, datë 10.11.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Bashkim Dedja	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 29.6.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Vefa” shpk në administrim, përfaqësuar nga Astrit Qerimi dhe avokat Luan Muha.

SUBJEKTI I INTERESUAR:

Gjergj Habilaj, përfaqësuar nga avokati Islam Llapi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2008-149, datë 1.2.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 16, 42, 43, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar që u shpreh për rrëzimin e saj dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Midis ish-shoqërisë huamarrëse “VEFA” sh.p.k. dhe subjektit të interesuar Gjergj Habilaj është lidhur kontrata e huas nr.766, datë 24.12.1996. Me vënien në administrim të kësaj shoqërie, administratorët kanë marrë disa vendime në lidhje me Gjergj Habilaj, si: vendimi nr.30, datë 31.8.1999, i cili e ka shpallur Gjergj Habilaj debitor në shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë; vendimi nr.57, datë 7.10.1999 me objekt “Mbi lirimin e Gjergj Habilaj nga detyrimi i shpallur”; vendimi i datës 14.11.1999, me objekt “Mbi sistemimin, rakordimin dhe shpërndarjen e kartelës së Gjergj Habilaj”, që ndryshon vendimin nr.57, datë 7.10.1999; vendimi nr.460, datë 12.11.2002, që ka anuluar vendimin e datës 14.11.1999, dhe ka përfshijtur Gjergj Habilaj nga lista e kreditorëve, pasi kontrata e tij rezultonte me tepriçë debitore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.1254, datë 8.7.2003, ka vendosur pranimin e padisë të Gjergj Habilaj, me objekt njohjen si kreditor dhe anulimin e vendimit nr.460, datë 12.11.2002 të shoqërisë “VEFA” sh.p.k. në administrim.

Gjykata e Apelit Vlorë, mbi ankimin e shoqërisë “VEFA” sh.p.k. në administrim, me vendimin nr.461, datë 20.10.2004, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, e ka rrëzuar padinë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr.361, datë 21.2.2005 ka vendosur mospranimin e rekursit të Gjergj Habilaj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.760, datë 22.12.2008, ka vendosur “Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr.460, datë 12.11.2002 të administratorëve të përbashkët të shoqërisë “VEFA” sh.p.k. në administrim”.

Subjekti i interesuar, Gjergj Habilaj i është drejtuar edhe Gjykatës së Apelit Tiranë, me kërkesëpadinë me objekt “Detyrimin e palës së paditur, “VEFA” sh.p.k. në administrim, për ta përfshirë paditësin në listën e kreditorëve të kësaj shoqërie” dhe, me vendimin nr.94, datë 28.9.2005, kjo gjykatë ka vendosur të pranojë kërkesëpadinë, duke detyruar palën e paditur, “VEFA” sh.p.k. në administrim, për ta përfshirë paditësin në listën e kreditorëve të kësaj shoqërie. Po ashtu, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.114, datë 10.11.2005 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr.94, datë 28.9.2005.

Shoqëria “VEFA” sh.p.k. në administrim i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për të rivendosur në afat të drejtën e ushtrimit të rekursit ndaj vendimit nr.94, datë 28.9.2005, kërkesë, e cila është pranuar me vendimin nr.243, datë 24.11.2006 të kësaj Gjykate. Vendimi për rivendosjen në afat është kundërshtuar me recurs në Gjykatën e Lartë nga subjekti i interesuar Gjergj Habilaj dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.618, datë 9.5.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.243, datë 24.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat të rekursit.

Me shpalljen e vendimit nr.243, datë 24.11.2006, administratorët e shoqërisë “VEFA” sh.p.k. në administrim kanë paraqitur recurs (subjekti i interesuar ka paraqitur kundër recurs) në Gjykatën e Lartë me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e ushtruar nga “VEFA” sh.p.k. në administrim, me vendimin nr.00-2008-149, datë 1.2.2008, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Në përfundim të proceseve gjyqësore në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm si kërkuesi, ashtu dhe subjekti i interesuar i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Gjergj Habilaj ka paraqitur kërkesë me objekt “Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë”. Kjo Gjykatë, me vendimin nr.8, datë 12.3.2009, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, pasi kërkuesi ka hequr dorë nga kërkesa e tij.

Shoqëria “VEFA” sh.p.k. në administrim ka paraqitur kërkesë me objekt “Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.461, datë 20.10.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë”. Kjo Gjykatë, me vendimin nr.70, datë 11.9.2009, ka vendosur mospranimin e kërkesës.

Kërkuesi, në datën 27.1.2010, i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2008-149, datë 1.2.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Sipas kërkuesit, në gjykimet e zhvilluara është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtimitet e mëposhtme:

- Është cenuar parimi i sigurisë juridike, për shkak të mosrespektimit të parimit të gjësë së gjykuar nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Gjykata e Apelit Tiranë (vendim nr.94, datë 28.9.2005) ka marrë në shqyrtim një mosmarrëveshje, e cila është shqyrtuar edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë (vendim nr.461, datë 20.10.2004) me të njëjtin objekt, shkak e palë.

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) duhet të pranonte rekursin kundër vendimit nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

Subjekti i interesuar, Gjergj Habilaj, ka parashtruar këto prapësime:

- Kërkesa për shfuqizimin e vendimit nr. 94, datë 28.9.2005 është jashtë afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

- Mjetet procedurale për kundërshtimin e vendimit kanë shteruar, pasi: (i) vendimi nr.94, datë 28.9.2005 ka marrë formë të prerë në momentin e shpalljes së tij, fakt ky i pranuar edhe nga sektori juridik i grupit të administratorëve të shoqërisë “VEFA” sh.p.k. në administrim; (ii) rekursi kundër

vendimit të formës së prerë është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në nenin 472/5 të KPC; (iii) Administratorët e pavarur të shoqërisë “VEFA” sh.p.k., me vendimin nr.508, datë 18.12.2005, e kanë shpallur atë “kreditor”.

- Kërkesa është shqyrtuar më parë nga Kolegji i kësaj Gjykate, i cili me vendimin nr.70, datë 11.9.2009 ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

- Procesi në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe të gjësë së gjykuar, për faktin se çështja nuk ka lidhje me atë të gjykuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, pasi ato kanë objekt dhe bazë ligjore të ndryshme.

II

Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit

Kërkuari i është drejtuar Gjykatës duke pretenduar moszbatimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të cenimit të parimit të sigurisë juridike, për shkak të mosrespektimit të parimit të gjësë së gjykuar nga gjykatat e sistemit të zakonshëm.

Gjykata konstaton se kërkuari, shoqëria “VEFA” sh.p.k. në administrim, është person juridik publik. Në kuptim të nenit 16/2 të Kushtetutës, edhe personat juridikë mund të jenë bartës të të drejtave e lirive themelore, për aq sa këto të drejta e liri përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e vetë të drejtave e lirive themelore.

Në jurisprndencën e saj, Gjykata është shprehur se personat juridikë publikë legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues kur ata marrin pjesë në qarkullimin civil dhe cenohen njëloj si të ishin qytetarë të thjeshtë, si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtpërdrejt me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre. Në këtë vështrim, personat juridikë publikë do të trajtohen si individë, në kuptim të nenit 134/1, shkronja “g” në lidhje me nenin 16/2 të Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.39, datë 23.12.2003*).

Gjykata ka vlerësuar se nisma për një gjykim kushtetues nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik, publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtrihen në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, të cilat duhet të kenë lidhje me cenimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009*).

Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në kuptim të neneve 131, shkronja “f”, 134, shkronja “g”, 16/2 dhe 42 të Kushtetutës, kërkuari, shoqëria “VEFA” sh.p.k. në administrim, mund t’i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që kanë lidhje me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike.

Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuari shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuari duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 1, datë 25.1.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet përmbushur nga kërkuari, pasi kontrolli i ushtruar nga kjo Gjykatë, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individ, përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Rregulli i shterimit të mjeteve nënkupton jo vetëm që ankuesi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 18.7.2005; nr.15, datë 18.4.2007; nr. 27, datë 20.6.2007; nr.23, datë 4.11.2008; nr.1, datë 19.1.2009; nr.32, datë 28.12.2009; nr.6, datë 4.3.2010*).

Nga rrethanat e çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuari nuk e ka ushtruar rekursin kundër vendimit nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda afatit të parashikuar nga neni

472 i KPC, ndonëse përbënte mjetin e përshtatshëm, të disponueshëm dhe efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Për këtë arsye, ai ka paraqitur kërkesë për rivendosje në afat, e cila është pranuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, por mbi rekursin e ushtruar nga subjekti i interesuar Gjergj Habilaj, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.618, datë 9.5.2007, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr.243, datë 24.11.2006 të Gjykatës së Apelit dhe rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat të rekursit”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr.00-2008-149, datë 1.2.2008, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga shoqëria “VEFA” sh.p.k. në administrim, me të cilin kundërshtohet vendimi nr.94, datë 28.09.2005 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave konkrete të çështjes, Gjykata vlerëson se mosushtrimi i rekursit brenda afatit procedural të përcaktuar nga ligji ose kur rekursi nuk rivendoset në afat, për nga pasojat juridike është i njëjtë me rastin kur rekursi nuk është ushtruar, ose kur pretendimi nuk është parashtruar më parë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuksi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, dhe për rrjedhojë, ka humbur mundësinë për të parashtruar përpara kësaj Gjykate pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të mosrespektimit të gjësë së gjykuar.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuksi, shoqëria “VEFA” sh.p.k. në administrim, nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike në dispozicion dhe, për këtë shkak, kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “a” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar) Petrit Plloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Bashkim Dedja.

Anëtar kundër: Xhezair Zaganjori

VENDIM

Nr.81, datë 11.11.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS AL” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Partners Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finacier dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec-et: “Shkallë”, “Cerrunje”, “Plesha”, “Bejni 1”, “Bejni 2”, “Klos”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.82, datë 11.11.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS AL” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.11.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finacier dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “ENERGY PARTNERS AL” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të En/Elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimi të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.83, datë 15.11.2010

**PËR MIRATIMIN E APLIKIMIT TË KESH SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE TË VITIT 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Aplikimi i KESH sh.a. për planin e investimeve për vitin 2011 përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e KESH sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.84, datë 15.11.2010

**PËR MIRATIMIN E APLIKIMIT TË “CEZ SHPËRNDARJA” SHA PËR MIRATIMIN E
PLANIT TË INVESTIMEVE TË VITIT 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarja” sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatohet se:

Aplikimi i “CEZ shpërndarja” sh.a. për planin e investimeve për vitin 2011 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e “CEZ shpërndarja” sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarja” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta**

VENDIM

Nr.85, datë 15.11.2010

**PËR MIRATIMIN E SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË OST SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT
TË INVESTIMEVE TË VITIT 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatohet se:

Aplikimi i OST sh.a. për planin e investimeve për vitin 2011 përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë aplikimin e OST sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta**

VENDIM
Nr.86, datë 15.11.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY - AL” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “f”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Supply-Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë, “Energy Supply-Al” sh.p.k në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.87, datë 15.11.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY-AL” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa ”a” dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pikat 1 germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.10 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.88, datë 15.11.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “RUDNAP ENERGY TIRANA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 13 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9 pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9 pika 4.10) .

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.89, datë 15.11.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ANSARA KONCESION” SHPK

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, 13 pika 1 germa “a”, 15 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a”, dhe nenit 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ansara Koncesion” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me paraqitjen e lejes mjedisore nga organet përkatëse është në proces përfundimi (neni 9 pika 4.1.5, germa “c”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Ansara Koncesion” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Labinot - Mal - Elbasan”, me fuqi 0.25 MW me kusht që shoqëria “Ansara Koncesion” sh.p.k. të dorëzojë lejen mjedisore, brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licencës.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.90, datë 15.11.2010

PËR DËNIMIN ME GJOBË TË “CEZ SHPËRNDARJA” SHA PËR SHKELJET E KONSTATUARA LIDHUR ME MOSZBATIMIN NGA ANA E SAJ TË VENDIMEVE TË ERE-S

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 64 pika “ç” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi dënimin me gjobë të “CEZ shpërndarja” sh.a. për shkeljet e konstatuara lidhur me moszbatimin nga ana e saj të vendimeve të ERE-s, si dhe u njoh me pretendimet e shoqërisë “CEZ shpërndarja” sh.a. (prezent në mbledhje), të pasqyruara dhe në procesverbalin bashkëlidhur këtij vendimi,

VENDOSI:

1. Dënimin me gjobë në shumën 350 000 lekë të shoqërisë “CEZ shpërndarja” sh.a. “Për moszbatim të kushteve të përcaktuara në licencë dhe konkretisht të pikës 3.1, të licencës për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”.

2. Të gjitha faturimet e kryera nga ana e “CEZ shpërndarje” sh.a. ndaj klientëve familjarë dhe jofamiljarë, me emërtimin “Dëm ekonomik” apo “Energji e pamatur” pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9997, datë 22.9.2008, janë të paligjshme.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarjen” për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Bujar Nepravishta

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 4.12.2010

Doli nga shtypi më 6.12.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë